



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 17.07.2019

VENDIM

Nr. 37, datë 17.07.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NËN MASËN 20 PËR QIND PËR PËRSHTATJE SIPAS VKM NR. 41, DATË 24.01.2018 NË PROGRAMIN E STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE NË MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE"

Mbështetur në pikën 9 të nenit 35, shkronjën **dh** të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.07.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë për ndryshime në masën 20 për qind për përshtatje sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 në programin e studimit "Master i shkencave në marrëdhënie ndërkombëtare" si më poshtë:
 - a) DRE 524 *Metodat e kërkimit shkencor*, 6 kredite, shtohet si lëndë e re;
 - b) DRE 517 *Ligji ndërkombëtar penal*, 7 kredite, ndryshon emërtimin në DRE 517 *E drejtë ndërkombëtare penale*, 8 kredite;
 - c) DRE 518 *E drejta e organizatave ndërkombëtare*, 8 kredite, hyn e re si lëndë karakterizuese duke zëvendësuar DRE 523 *Menaxhim krizash*, 6 kredite;
 - d) DRE 522 *Diplomaci*, 8 kredite, ndryshon emërtimin në DRE 522 *E drejtë diplomatike dhe konsullore*, 8 kredite;
 - e) DRE 512 *Gjeopolitikë* kalon lëndë me zgjedhje, nga 7 kredite në 6 kredite;
 - f) DRE 523 *Menaxhim krizash*, 6 kredite, kalon lëndë me zgjedhje.
2. Ky program studimi do të zbatohet për vitin akademik 2019-2020.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Dr. Elenica BEQIRAJ